



Janar 2022

Viti 2021 për SHUKALB në fokus – Mesazh nga Elisabeta Poçi, Drejtore Ekzekutive



Të nderuar Anëtarë, Partnerë dhe Miq,

Ndërsa përgatitemi për të hyrë në Vitin e Ri, dëshirojmë të shfrytëzojmë rastin dhe t'ju urojmë të gjithëve një vit të ri të gëzuar, të begatë dhe dhe plot shëndet për vitin 2022.

Pavarësisht vështirësive që hasëm këtë vit, për shkak të vazhdimit të pandemisë COVID, SHUKALB arriti të përmbushë objektivat e misionit të tij, duke kryer me sukses aktivitetet e tij dhe duke iu përshtatur situatës. Kam kënaqësinë të ndaj me ju një përmbledhje të disa prej momenteve kryesore të aktiviteteve dhe eventeve kryesore që SHUKALB ndërmori gjatë vitit që lamë pas.

Gjatë vitit 2021, në kuadër të **Programit të tij të Trajnimit**, SHUKALB zhvilloi 12 kurse trajnimi, 4 prej tyre të ofruara online, ku morën pjesë 210 pjesëmarrës nga 30 shoqëri ujësjellës kanalizime anembanë Shqipërisë, duke mbuluar tema si cilësia e ujit, kontrolli i rrjedhjeve, menaxhimi, menaxhimi financiar, humbjet e ujit, menaxhimi, pasqyrat financiare, plani i biznesit, raportimi financiar dhe fiskal, shërbimi ndaj klientit dhe marrëdhëniet me publikun dhe trajtimin e ujit të ndotur. [lexo më shumë](#)



Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Kurs hyrës në Politikën dhe Legjislacionin e BE-së për Ujin](#)

Online
25- 26 Janar 2022

[Sektori Gjerman i Ujit - fokus në Furnizimin me Ujë dhe Kanalizime](#)

Online
25- 27 Janar 2022

[LET2022 - Konferenca e 17-të e IWA-së për teknologjitë e ujit të pijshëm dhe ujit të ndotur](#)

Reno, Nevada, SHBA
27 Mars - 02 Prill 2022

Trajnime dhe programe të zhvillimit të kapaciteteve

SHUKALB zhvillon me sukses trajnimin e RCDN-së mbi “Projektet e Investimeve Kapitale Infrastrukturore në Sektorin Ujësjiellës Kanalizime”



Në datat 9, 16, 17 dhjetor 2021, në Tiranë, SHUKALB zhvilloi me sukses trajnimin e RCDN-së me temë “Projektet e Investimeve Kapitale Infrastrukturore në Sektorin Ujësjiellës Kanalizime”. Në trajnim morën pjesë 25 pjesëmarrës nga departamentet teknike, tregtare, ligjore dhe administrative të shoqërive ujësjiellës kanalizimeve të Tiranës, Shkodrës, Sarandës, Korçës, Vlorës dhe Gjirokastrës.

Trajnimi u organizua në kuadër të projektit “Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (RCDN)”. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB Organizon Workshopin e fundvitit të Projektit “Shërbime Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime në Evropën Jug Lindore”



Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Në datë 17 Dhjetor 2021, SHUKALB në bashkëpunim me SHUKOS (Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimit të Kosovës) organizuan workshopin e fundvitit të Projektit “Shërbimet Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve për Shoqëritë Ujësjetës Kanalizime në Evropën Jug Lindore”. Workshopi u organizua virtualisht nëpërmjet platformës MS Teams, ku morën pjesë menaxherë dhe staf nga Shoqëri UK në Shqipëri dhe KRU në Kosovë, përfaqësues nga institucione të qeverisë qendrore dhe lokale nga të dyja vendet, si dhe donatorë.

Qëllimi i këtij workshop ishte të prezantonte progresin e projektit gjatë vitit 2021, si dhe të informonte në lidhje me aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2022. [lexo më shumë](#)

Arbana Kola, Menaxhere e Projektit IAM, Zgjidhet Anëtare e Komitetit Menaxhues të Grupit të IWA-së të Specialistëve të Menaxhimit Strategjik të Aseteve



SHUKALB me krenari njofton se Arbana Kola, Menaxhere e Projektit Menaxhimit i Integruar i Aseteve, është zgjedhur së fundmi Anëtare e re e Komitetit Menaxhues të Grupit të IWA-së të Specialistëve të Menaxhimit Strategjik të Aseteve për periudhën Nëntor 2021 – Nëntor 2024.

Grupi i Specialistëve të Menaxhimit Strategjik të Aseteve (SAM SG)

është një grup për profesionistët e ujit për të punuar së bashku dhe për të shkëmbyer njohuri në drejtim të menaxhimit të asetëve infrastrukturore të shërbimeve të ujit urban në nivelet strategjike, taktike dhe operacionale, duke synuar arritjen e një ekuilibri midis performancës, riskut dhe kostos në terma afatgjatë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është angazhimi i vendeve në zhvillim dhe profesionistëve të rinj të ujit, si dhe promovimi i nismave rajonale. [lexo më shumë](#)

Elisabeta Poçi, Drejtore Ekzekutive e SHUKALB, merr pjesë në Forumin e dytë Evropian mbi Rregullimin e Shërbimeve të Ujit



Më 1 dhjetor 2021, Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit (WAREG) organizoi edicionin e dytë të Forumit Evropian për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (EFRWS). Forumi i dytë EFRWS u organizua rreth tranzicionit të gjelbër dhe veprimeve të ndërmarra nga institucionet evropiane dhe nga rregullatorët kombëtarë për të përmirësuar aktivitetet e bazuara në ekonomi qarkulluese në sektorin e ujit.

SHUKALB u përfaqësua në forum nga Elisabeta Poçi, Drejtore Ekzekutive, e cila ishte përzgjedhur si folëse në Panelin 4: Sfidat e Ujit në Ballkan, duke ndarë përvojën e SHUKALB me Programet e Trajnimit dhe Certifikimit. Paneli u fokusua në disa nga sfidat kryesore, arritjet dhe nevojat urgjente në sektorin e ujit dhe kanalizimeve në vendet candidate në BE, dhe rolin e rregullatorëve kombëtarë në zbatimin e kërkesave legislative acquis të BE-së për ujin. Paneli u bashkëmoderua nga Ndriçim Shani, Kryetar i Entit Rregullator të Ujit të Shqipërisë dhe Walter Kling, President i Shoqatës Ndërkombëtare të Kompanive Ujësjetllës Kanalizime në Zonën e Mbulimit të Lumit Danub (IAWD). [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, Web: www.shukalb.al

Çregjistrohu